

**LIGJI Nr. 04/L-006
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.02/L-123 PËR SHOQËRITË TREGTARE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.02/L-123 PËR SHOQËRITË TREGTARE

Neni 1

1. Në tërë tekstin e ligjit bazik togfjalëshi **“kapitali themeltar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar”** të fshihet nga teksti i ligjit.
2. Në tërë tekstin e ligjit bazik togfjalëshi **“Mbledhja e pronarëve”** zëvendësohen me togfjalëshin **“Kuvendi i aksionarëve”**.
3. Në tërë tekstin e ligjit bazik nocioni dhe shkurtesa **“NI” - Ndërmarrje Individuale**, zëvendësohet me nocionin dhe shkurtesën **“B.I.”- Biznes Individual**.
4. Në tërë tekstin e ligjit bazik nocioni dhe shkurtesa **“SHKL”- Shoqëri Kolektive** zëvendësohet me nocionin dhe shkurtesën **“O.P.”- Ortakëri e Përgjithshme**.
5. Në tërë tekstin e ligjit bazik shkurtesa **“SHKM” - Shoqëri komandite** zëvendësohet me shkurtesën **“SH.K.M” - Shoqëri komandite**.
6. Në tërë tekstin e ligjit bazik shkurtesa **“SHPK” - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**, zëvendësohet me shkurtesën **“SH.P.K” Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.
7. Në tërë tekstin e ligjit bazik shkurtesa **“SHA” - Shoqëri Akcionare**, zëvendësohet me shkurtesën **“SH.A.”- Shoqëri akcionare**.
8. Në tërë tekstin e ligjit bazik fjala **“Kompani”** zëvendësohet me fjalën **“Korporatë”**.
9. Në tërë tekstin e ligjit bazik fjala **“Memorandum”** zëvendësohet me fjalën **“Marrëveshje”**.

Neni 2

1. Në tërë tekstin e ligjit bazik afati prej gjashtëdhjetë (60) ditësh zëvendësohet me afatin tridhjetë (30) ditë.
2. Në tërë tekstin e ligjit bazik afati prej dhjetë (10) ditësh kalendarike zëvendësohet me afatin tri (3) dite pune.
3. Në tërë tekstin e ligjit bazik afati prej njëzet (20) ditësh zëvendësohet me afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Neni 3

Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. pas fjalës “**të këtij ligji**” pjesa e dytë e paragrafit fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 4

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 2.1. përkufizimi “**Zyra e regjistrimit**” zëvendësohet me përkufizimin “**Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës**” (ARBK). Ky ndryshim vlen për tërë tekstin e ligjit.

2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 2.1. përkufizimi “**Udhëheqësi i Zyrës së Regjistrimit**” zëvendësohet me përkufizimin si në vijim “**Kryeshef ekzekutiv i Agjencisë të regjistrimit të biznesit të Kosovës**” (ARBK-së). Ky ndryshim vlen për tërë tekstin e ligjit

3. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 2.1. përkufizimi “**Anëtarë i Familjes**” riformulohet si vijon: “**Anëtarë i Familjes**” - nënkupton familjen e ngushtë si burri, grua, fëmijë, prindi ose trashëgimtari ligjor.

4. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 2.1. përkufizimi “**Person Juridik**” riformulohet si vijon: “**Person Juridik**” - Statusin e personit juridik sipas këtij ligji e kanë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SH.P.K.” dhe shoqëria aksionare “SH.A.”.

Neni 5

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3.3. riformulohet si vijon:

3.3. Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni ose paragrafin 2. të nenit 37 të këtij ligji, nëse një person i cili nuk është i regjistruar ushtron veprimtari tregtare në Kosovë, atëherë personi në fjalë ka bërë shkelje të këtij ligji, dhe dënohet sipas Kodit Penal të Kosovës.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3.4. riformulohet me tekstin si vijon:

3.4. Për personat ose shoqëritë të cilat bëjnë shkeljet e parapara në paragrafin 3. të këtij neni ose ndonjë shkelje tjetër të këtij ligji, shuma e gjobave për kundërvajtje përcaktohet në:

- a). proporcion me shkallën e shkeljes;
- b). në masë të mjaftueshme për t'i parandaluar këto shkelje.

Neni 6

1. Neni 7 të ligjit bazik, pas paragrafit 7.5. shtohen dy paragrafë të ri si vijon:

7.6 Agjencia bënë regjistrimin e ndërmarrjeve publike të cilat kanë përfunduar procedurat e korporatizimit dhe janë transformuar në korporata dhe kooperativat bujqësore.

7.7. Regjistrimi i ndërmarrjeve shoqërore të korporatizuara bëhet në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 7

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 10.5. riformulohet si vijon:

10.5. Cilido person i cili konsideron se Agjencia e Regjistrimit ose një zyrtar i punësuar në të, nuk është duke i përmbushur kushtet e parapara në këtë nen, mund të parashtojë ankesë Kryeshefit të Agjencisë të Regjistrimit të Bizneseve i cili vendos për ankesën në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të sajë.

2. Neni 10 i ligjit bazik, pas paragrafit 10.5. shtohen edhe katër paragrafë të ri si vijon:

10.6. Nëse Kryeshefi i Agjencisë nuk e shqyrton ankesën apo me vendim refuzon ankesën atëherë parashtruesi i ankesës në afat prej tete (8) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit mund të parashtrrojë ankesë të Komisioni për parashtrësia dhe ankesa ne kuadër te MTI-se.

10.7. Komisionin për parashtrësia dhe ankesa në kuadër të MTI-së është i autorizuar dhe është përgjegjës për ta shqyrtuar këtë ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i sajë.

10.8. Nëse Komisioni aprovon ankesën e palës ai do të kërkojë nga Kryeshefi i Agjencisë së Regjistrimit të Biznesit që të ndërmerr masa të kërkuara për eliminimin e parregullsive.

10.9. Nëse Komisioni refuzon ankesën e palës apo nuk përgjigjet në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dorëzimi i ankesës, parashtruesi i ankesës mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente.

Neni 8

1. Titulli i nenit 12 të ligjit bazik **“Taksa për regjistrim”** ndryshohet dhe riformulohet si vijon: **“Taksa për shërbime”**.

2. Neni 12 i ligjit bazik paragrafi 12.1. riformulohet si vijon:

12.1. Bizneset me rastin e regjistrimit nuk paguajnë taksë. Ministri me akt nënligjor do të përcaktoj listën e taksave të cilat do të paguhen për shërbimet tjera të ofruara nga Agjencia.

Neni 9

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 13.9. riformulohet si vijon:

13.9. Personi i cili është “person i autorizuar” sipas paragrafëve 7. dhe 8. të këtij neni, mundet – me qëllim të dorëzimit të informatave ose dokumenteve në Zyrën e Regjistrimit ose që të përfaqësojë shoqërinë përkatëse tregtare në atë zyrë – të caktojë një person që të veprojë në emër të tij. Ky caktim duhet të bëhet me shkrim dhe të datohet nga personi i autorizuar. Personi i cili është “person i autorizuar” vepron në emër të tij pran Zyrës së Regjistrimit përmes një autorizimi në formë të shkruar.

2. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafit 13.12. pas pikës b). shtohet pika e re c). si vijon:

c). te krijoj qendrat e regjistrimit ne nivel komunal dhe te behet pike qendrore e mbledhjes dhe shpërndarjes se dokumenteve te nevojshme për regjistrim, mbikëqyrjen mbi veprimtarin profesionale e kryen ARBK.

3. Neni 13 i ligjit bazik, pas paragrafit 13.13. shtohet edhe një paragraf i ri 13.14 si vijon:

13.14. Shoqëri tregtare mund të themelojnë vetëm personat mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Neni 10

1. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi 14.2. afati prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) ditësh ndryshon dhe zëvendësohet me afatin prej tri (3) deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike.

2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi 14.4. riformulohet si vijon:

14.4. Nëse Agjencia e Regjistrimit të Biznesit konstaton se një dokument i dorëzuar për regjistrim nuk i përmbush një ose më shumë nga kushtet e këtij ligji dhe për këtë shkak nuk mund të regjistrohet, në afat prej tri (3) ditë pune nga dita e pranimi të këtij dokumenti, duhet ta njoftoj shoqërinë tregtare ose përfaqësuesin e saj zyrtar, përmes postes elektronike, postes zyrtare, bazuar me ligjet në fuqi.

Neni 11

Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 17.3. riformulohet si vijon:

17.3. Pala e pa kënaqur me vendimin e Kryeshefit të ARBK-së në afatin prej tetë (8) ditësh ushtron ankesë në Komisionin për parashtrësia dhe ankesa. Kundër vendimit të Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa pala e pa kënaqur në afatin prej tridhjetë (30) ditësh mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Neni 12

Neni 19 i ligjit bazik, afati prej pesë (5) viteve për ruajtjen e të dhënave dhe dokumenteve në letër, ndryshohet dhe bëhet në bazë të Ligjit nr 2003/7 për arkivat dhe lenden arkivore.

Neni 13

1. Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1 pika (e) teksti pas fjalës “**jashtë Kosovës**” fshihet dhe fjalia riformulohet me tekstin si vijon: “**Nëse një themelues është person juridik, emrin dhe adresën e selisë së regjistruar apo emrin dhe adresën zyrtare të selisë ku ushtrohet veprimtaria kryesore, që mund të jetë në Kosovë ose jashtë Kosovës**”.

2. Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1 pikat h), i). dhe j). fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 14

Neni 34 i ligjit bazik paragrafi 34.1 pika d) fjala “**deklaratë**” zëvendësohet me fjalën “**vendim**”. Po ashtu në të njëjtën pikë fshihet lidhëza “**dhe**”.

Neni 15

1. Neni 35 i ligjit bazik paragrafi 35.1 pika i). ndryshon shuma e kapitalit themeltar nga njëzetepesëmijë (25.000) në dhjetëmijë (10.000) Euro.

2. Neni 35 i ligjit bazik paragrafi 35.1 pikat j). dhe k). fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 16

Neni 36 i ligjit bazik paragrafi 36.3. pika d). nocioni “**deklaratë**” zëvendësohet me nocionin “**vendim**”.

Neni 17

1. Neni 37 i ligjit bazik, paragrafi 37.3. riformulohet si vijon:

37.3. Nëse një shoqëri e huaj tregtare është e detyruar sipas paragrafit 1. të këtij neni që të regjistrohet në Agjencia e Regjistrimit të Biznesit, personi i autorizuar duhet të nënshkruajë dhe dorëzojë në ARBK-ë “Vendimin e shoqërisë së huaj tregtare” dhe që përfshin këto të dhëna:

2. Neni 37 i ligjit bazik, paragrafi 37.3 pika b). riformulohet me si vijon:

b). Certifikatën e regjistrimit të shoqërisë së huaj në vendin e origjinës, apo dokumentin që është ekuivalent me Certifikatën e regjistrimit e cila duhet të jetë në origjinal apo e noterizuar, jo më e vjetër se tre muaj nga data e lëshimit dhe që provon themelimin e rregullt të shoqërisë së huaj tregtare në atë juridiksion. Nëse Certifikata nuk është në gjuhën shqipe serbe apo angleze e njëjta të jetë e përkthyer në njërën nga këto tri gjuhë dhe përkthimi duhet të jetë i noterizuar. Dokumentit i bashkëngjitet vendimi.

Neni 18

1. Neni 39 i ligjit bazik, paragrafi 39.1 pas pikës g). shtohet pika h). si vijon:

h). Personi i autorizuar i bashkangjet njoftimit vërtetimin në origjinal të administratës tatimore të Kosovës me të cilën vërtetohet se shoqëria i ka përmbush te gjitha obligimet tatimore.

Neni 19

Nenet 42, 43 dhe 79 të ligjit bazik fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 20

Neni 80 i ligjit bazik paragrafi 80.1 pas fjalës “asete”, pjesa tjetër e tekstit fshihet.

Neni 21

Neni 81 te ligjit bazik fshihet pjesa e tekstit të nenit si vijon: “**dhe t’i ketë siguruar Zyrës së Regjistrimit dëshmi mbi pagimin e kapitalit themeltar sipas nenit 79 të këtij ligji**”, ndërsa pjesa e tekstit në vazhdim mbetet e pa ndryshuar.

Neni 22

Neni 84 i ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të ketë themelues dhe akcionar një ose më shumë persona fizik ose persona juridik, duke përjashtuar OJQ-të.

Neni 23

Neni 86 i ligjit bazik paragrafi 86.2 në pikën d). fshihet pjesa e tekstit si vijon: “**ose do të jenë në përputhje me kapitalin e deponuar**”.

Neni 24

Në kreun e VIII te ligjit bazik para nenit 106 shtohet neni 106A me këtë tekst:

Neni 106 A

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar qeveriset nga Kuvendi i aksionarëve dhe nga drejtori apo drejtorët Menaxhues. Shoqëria mund të krijojë dhe mbajë një Bord të drejtorëve nëse kjo është e rregulluar me marrëveshjen e shoqërisë dhe statut. Nëse shoqëria krijon Bordin e drejtorëve autorizimet e tij, numrin e anëtarëve, mënyrën e zgjedhjes, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë si dhe mënyrën e votimit në Bord do ta përcaktojë marrëveshja dhe statuti i shoqërisë.

Neni 25

Neni 127 i ligjit bazik paragrafi 127.1 shuma prej njëzetepesëmijë (25.000) zëvendësohet me shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro.

Neni 26

Neni 153 i ligjit bazik paragrafi 153.1 shuma prej njëzetepesëmijë (25.000) zëvendësohet me shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro.

Neni 27

1. Neni 184 i ligjit bazik paragrafi 184.1 riformulohet si vijon:

184.1. Secili zyrtar ose drejtor duhet t'i shmangët konflikteve aktuale dhe potenciale mes interesave personale dhe atyre të kompanisë, është i detyruar të lajmërojë para bordit të drejtorëve ose para një komisioni vendimmarrës (ose kur zbatohet para aksionarëve, nëse ata e marrin vendimin përkatës) çfarëdo interesi personal ose financiar që ai ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes të afërmeve ose bashkëpunëtorëve personal, në lidhje me si vijon, qofshin ato ekzistuese ose potenciale (i) kontrata ose transaksione, (ii) konkurrentë afaristë (iii) kreditorë, (iv) furnizues, (v) klientë, (vi) konsulentë, (vii) punonjës, (viii) ortakë dhe/ose (ix) çfarëdo vendimi të kompanisë, bordit të drejtorëve ose të aksionarëve që ndërlidhet me të mësipërmet”.

2. Neni 184 i ligjit bazik paragrafi 184.3. pas fjalës “**aksionarët**” teksti në vazhdim ndryshohet dhe plotësohet si vijon: “**Ky lajmërim duhet të publikohet në mediat masive si pjesë e raportimit vjetor financiar në pajtim me Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe të përfshij të gjithë informacionin material rreth palëve të transaksionit; natyrës dhe fushëveprimit të interesave të palëve të përfshira; dhe ndonjë informacion relevant lidhur me transaksionit. Ne të njëjtin paragraf pas fjalës moslajmërimit , shtohet fjalia “të dorëzoj fitimin e tij nga transaksioni”.**

3. Neni 184 i ligjit bazik pas paragrafit 184.4. shtohen edhe pesë paragrafë të ri me tekstin si vijon:

184.5. Transaksionet e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni duhet të miratohen me shumicën votave të aksionarëve që nuk kanë interes në transaksionin përkatës, apo në rast se transaksioni është vendim i një aksionari të vetëm, atëherë ky transaksion po ashtu miratohet me shumicën e votave të aksionarëve.

184.6. Në rast të paraqitjes së transaksioneve të përshkruara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, aksionarët mund të padisin palën e interesuar dhe të kërkojnë kompensim për dëmet si dhe dorëzimin e fitimit të realizuar nga ky transaksion, nëse vërtetohet se kompania ka pësuar dëme si rezultat i transaksionit dhe se ky transaksion do të mbyllej me kushte më të mira nëse s'do të kishte ekzistuar konflikti i interesit në transaksionin përkatës. Transaksioni i aprovuar nga takimi i përgjithshëm i aksionarëve nuk heq përgjegjësin e zyrtarëve nëse transaksioni është parajgykues apo i dyshimtë ndaj kompanisë ose aksionarëve.

184.7. Gjykata kompetente mund t'i shfuqizojë transaksionet e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni nëse vërtetohet se kompania ka pësuar dëme si rezultat i transaksionit dhe se ky transaksion do të mbyllej me kushte më të mira nëse nuk do të kishte konflikt të interesit në transaksionin përkatës.

184.8. Drejtorët e kompanisë lirohen nga përgjegjësia në rast se votojnë kundër vendimit të miratuar nga trupi i kompanisë i cili ka rezultuar me humbje për kompaninë dhe aksionarët.

184.9. Aksionari apo aksionarët të cilët paraqesin padi në Gjykatën kompetente për shfuqizimin e transaksioneve të përshkruara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, kanë të drejtë në qasje të plotë në dokumentacionin që ndërlidhet me transaksionet e kontestuara para dhe gjatë procedurës gjyqësore

4. Neni 184 i ligjit bazik, paragrafit 184.5. rinumërohet si paragraf 184. 10.

Neni 28

Neni 188.3 i ligjit bazik pas fjalës “**te pranuar**” shtohet togfjalëshi “**dhe fitimet.**”

Neni 29

Neni 192 i ligjit bazik, paragrafi 192.1. në piken f). pas fjalës “**shoqërisë**” shtohet teksti si vijon: “**te cilat duhet te përgatiten ne pajtim me standardet ndërkombëtare te raportimit financiar (SNRF) dhe te publikohen ne baza vjetore ne mediat masive dhe**”.

Neni 30

1. Neni 221 i ligjit bazik teksti ekzistues rinumërohet si paragraf 221.1. dhe ndryshohet përqindja nga “**50%**” në “**20%**”.

2. Neni 221 i ligjit bazik pas paragrafit të rinumëruar si paragrafi 221.1. shtohet edhe një paragraf i ri 221.2. si vijon:

221.2. Në rast se transaksionet e përcaktuara ne paragrafin 1. dhe 2. te nenit 184, kalojnë 20% të aseteve të kompanisë, Bordi i drejtorëve do te kërkoj një mendim te shkruar te pavarur mbi transaksionin nga një këshilltar financiar i pavarur profesional i licencuar nga autoriteti qendror bankar apo ndonjë autoritet ekuivalent i licencuar jashtë kosoves me qellim te shqyrtimit te kushteve te transaksionit si dhe te vlerësoi nëse transaksioni është ne pajtueshmëri me çmimin e tregut, Ky vlerësim iu prezantohet aksionarëve se paku pesë (5) dite para aprovimit te transaksionit nga takimi i jashtëzakonshëm i aksionareve .

Neni 31

Neni 232 i ligjit bazik, paragrafi 232.1. pika a). fshihet nga teksti “**ne rast te mos dorëzimit te raportit vjetor ose**” ndërsa teksti tjetër i këtij paragrafi mbetet i njëjtë.

Neni 32

Neni 236 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 33

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2008/26, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/6, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr.2002/22 dhe Udhëzimi administrativ Nr.2003/1.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-006
23 qershor 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-008-2011, datë 08.07.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.